



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RAPORTI I VEPRIMTARISË

PËR VITIN

2017



Përmbajtja

1.	Akronime.....	3
2.	Përmbledhje Ekzekutive.....	3
3.	Bordi i Mbikëqyrjes Publike	4
3.1.	Misioni dhe objektivat e BMP	4
4.	Risitë e BMP-së.....	7
5.	Theksimi Aktiviteteve Kryesore	8
6.	Në proces diskutimi.....	12
7.	Bashkëpunimi BMP dhe organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit.	13
7.1.	Bashkëpunimi me organizatat kombëtare	13
7.2.	BMP – Anëtar i IFIAR.....	14

1. Akronime

BMP Bordi i Mbikëqyrjes Publike

BB Banka Botërore

BE Bashkimi Evropian

NJIP Njësitë me Interes Publik

KPAP Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

KIDB Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike

IFIAR Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Auditimit

VKM Vendim i Këshillit të Ministrave

2. Përmbledhje Ekzekutive

2.1. Prezantim

Bordi i Mbikëqyrjes Publike u krijua në tetor 2009 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Me ndryshimet e reja ligjore në ligjin 47/2016 roli i Bordit të Mbikëqyrjes Publike u përmirësua dukshëm duke pasqyruar frymën e institucioneve homologe brenda Bashkimit Evropian si dhe kërkesat e dhe rregullores 537 të BE.

Pas këtyre ndryshimeve Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka marrë statusin e autoritetit të pavarur rregullator duke realizuar mbikëqyrjen publike të profesionit të auditimit dhe firmave të auditimit, qoftë drejtpërdrejt, nëpërmjet mbikëqyrjes së audituesve ligjorë dhe firmave të auditimit, qoftë nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Po në kuadër të këtyre ndryshimeve BMP është autoriteti përgjegjës për rregullimin e profesionit të kontabilistëve të miratuar dhe organizatave profesionale përkatëse.

2.2. Subjekte që mbikëqyren nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Subjektet që mbikëqyren nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike janë :

- Organizata Profesionale e Audituesve Ligjor (IEKA) së bashku me komitetet e ngritura pranë saj;
- Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë e Auditimit;
- Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të miratuar
 - Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
 - Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë
 - Shoqata e Kontabilistëve të Miratuar
- Kontabilistët e Miratuar dhe Shoqëritë e Kontabilitetit

3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike

3.1. Misioni dhe objektivat e BMP

Misioni: Rritja e sigurisë në auditimet ligjore të cilat kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik si dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar.

Objektivat strategjike të BMP janë si më poshtë:

Rritja e besimit të publikut në cilësinë e raportimit financiar dhe krijimi i një mjedisi transparent dhe të mirë mbikëqyrur lidhur me shërbimet që ofrojnë profesionistët kontabël dhe rolin e organizatave profesionale subjekt i mbikëqyrjes.

Bashkërendimi i veprimtarisë me të gjitha institucionet dhe rregullatorët apo autoritetet e tjera në funksion të mbrojtjes së interesit të publikut.

Bashkërendimi i veprimtarive me institucionet e tjera homologe rajonale dhe ndërkombëtare më fokus përmirësimin e praktikave dhe sistemit të mbikëqyrjes.

3.2. Përbërja e BMP-së

BMP përbëhet nga pesë anëtarë jo-praktikues, të cilët janë ekspertë në fushat përkatëse të auditimit ligjor, emëruar nga Ministri përgjegjës për financat, me mandat për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtën për t'u rizgjedhur jo më shumë se dy herë. Anëtarët e Bordit janë përzgjedhur bazuar në kriteret të përcaktuara dhe përmes një procedure konkurrence të pavarur dhe transparente.

Bazuar në ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; dhe VKM-së nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” e ndryshuar; si edhe në Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 27, datë 24.3.2017 “Për emërimin dhe mandatimin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” është krijuar dhe funksionon BMP me përbërje si në vijim:

Dritan Fino	Kryetar
Adriana Berberi	Anëtare
Edlira Luçi	Anëtare
Luan Abazi	Anëtar
Klement Mersini	Anëtar

3.3. Struktura Mbështetëse

Për të realizuar objektivat si dhe për të ushtruar funksionet e tij, Bordi asistohet nga një Strukturë Mbështetëse. Funksionimi i Strukturës Mbështetëse rregullohet në përputhje me Rregulloren për Strukturën Mbështetëse në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Struktura mbështetëse do të përbëhet nga stafi përgjegjës për kryerjen e kontrollit të cilësisë dhe proceseve të tjera të lidhura me kontrollin e cilësisë dhe mbikëqyrjen si dhe nga stafi apo personeli administrativ i cili është i domosdoshëm për administrimin e veprimtarisë së Bordit.

3.4. Përgjegjësitë e BMP-së

Sipas Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimi i profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar ", i ndryshuar, Neni 5, BMP ka këto të drejta dhe detyra:

- harton rregullat e funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, të cilat i paraqiten për miratim autoriteteve të parashikuara në këtë ligj;
- mbikëqyr, monitoron dhe vlerëson zbatimin e procedurave të testimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese;
- miraton formatin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive audituese, të regjistruara nga Komiteti i Regjistrimit, si dhe mbikëqyr respektimin e rregullave, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
- miraton kodin e etikës të audituesve ligjorë e të shoqërive audituese, të përgatitur dhe të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe mbikëqyr zbatimin e standardeve të këtij kodi;
- harton dhe Miraton Rregulloren e Kontrollit të Cilësisë dhe manualin përkatës lidhur me kontrollin e cilësisë;
- mbikëqyr procesin e kontrollin të cilësisë dhe zbatimin e dispozitave të rregullores së Kontrollit të Cilësisë;
- mbikëqyr programet dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional të audituesve ligjorë;
- miraton rregulloret e investigimit dhe të procedurave për marrjen e masave disiplinore;
- mbikëqyr përmes komisioneve të SM veprimtarinë e Komisioneve të Investigimit të Organizatave Profesionale;
- kur e gjykon të nevojshme, kryen investigime shtesë për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;
- shqyrton dhe merr vendim për ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me regjistrimin e tyre;
- miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarive të tij;
- shqyrton dhe merr vendim për rastet e shkeljeve disiplinore, që janë kompetencë e tij;

- miraton akte të tjera rregullatorë, të cilat janë në kompetencën e tij;
- shqyrton dhe merr vendim për aspekte apo çështje të tjera, të parashikuara në këtë ligj, që janë brenda objektit të veprimtarisë së tij;
- miraton statutet e organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit dhe mbikëqyr organizimin dhe funksionimin e tyre.

4. Risitë e BMP-së

4.1. Struktura Mbështetëse dhe Komisionet

Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe statutin e miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike përveç strukturës mbështetëse pranë BMP-së ngrihen komisione dhe grupe pune për realizimin e misionit dhe arritjen e objektivave të vendosura.

Komisionet dhe grupet e punës që planifikohen të ngrihen pranë BMP-së do të kenë në fokus aktivitetet e lidhura me:

- kontrollit të cilësisë;
- edukimit dhe kualifikimit të vijueshëm të profesionistëve kontabël;
- investigimit dhe disiplinës;
- pajtueshmërisë ligjore;
- raportimit financiar;
- etikës;
- parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- kontrollit të brendshëm;
- studimore, kërkimore, akademike, publikimi çështje të tjera që lidhen me veprimtarin e bordit apo që i shërbejnë bordit për të ushtruar kompetencat e veta.

4.2. Vetëfinancimi nga të ardhurat e tjera pa prekur Buxhetin e Shtetit

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mbështetje të rregullores për Mbledhjen e të ardhurave parashikon që të vetëfinancohet plotësisht në kryerjen e aktiviteteve të veta. Sipas kësaj rregullore dhe strategjisë së miratuar të BMP-së nuk planifikohet të kërkohet financim nga Buxheti i Shtetit. Vetëfinancimi është konsideruar si qasja më e mirë për të garantuar cilësinë e aktiviteteve të mbikëqyrjes dhe mbrojtjen e interesit publik pa krijuar kosto për taksapaguesit.

4.3. Bursa dhe shpërblime për kandidatët më të mirë për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar

Bordi për herë të parë ka planifikuar dhënien e shpërblimeve për kandidatët më të mirë për auditues ligjor gjithashtu në rregulloren për mbledhjen e të ardhurave është parashikuar edhe shpërblime të tjera jo vetëm për kandidatët për auditues ligjor por edhe për kandidatët për kontabilist të miratuar të financuara përmes memorandumëve të bashkëpunimit me institucione apo organizata që vullnetarisht kërkojnë të mbështesin përmirësimin e cilësisë dhe rolit të profesionistëve kontabël.

5. Theksimi Aktiviteteve Kryesore

1. Emërimi i Anëtarëve të BMP-së
2. Angazhimi i Konsulentit Ndërkombëtar (PKF)
3. Angazhimi i Ekspertëve Lokalë
4. Miratimi i Statutit të BMP-së
5. Miratimi i Rregullores për Mbledhjen e të Ardhurave
6. Përgatitja e Projekt Rregullores për funksionimin e KPAP-së
7. Përgatitja e Projekt Rregullores për KIDB
8. Regjistrimi dhe Vula e BMP-së
9. Përgatitja e Strategjisë së Funksionimit të BMP-së

24 Mars 2017 Emërimi i Anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 27, “Për emërimin dhe mandatimin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike datë 24.3.2017 u bë emërimi i anëtarëve të rinj të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Dritan Fino	Kryetar
Adriana Berberi	Anëtare
Edlira Luçi	Anëtare
Luan Abazi	Anëtar
Klement Mersini	Anëtar

Maj 2017 Angazhimi i konsulentit ndërkombëtar PKF

Është angazhuar konsulenti ndërkombëtar PKF. Qëllimi kryesor i këtij konsulenti është të ofrojë asistencë teknike, trajnim - duke përfshirë trajnimin për punë për të përmirësuar funksionimin e Bordit Mbikëqyrës Publike, si dhe për të rritur kapacitetin e BMP-së në monitorimin dhe zbatimin e cilësisë më të lartë të pasqyrave financiare të bazuara në SNRF, të përgatitura nga NJIP

Maj 2017 Qershor Angazhimi i Ekspertëve Lokal në kuadër të Projektit Për Përmirësimin e Cilësisë Së Raportimit “ENHANCING QUALITY OF FINANCIAL REPORTING PROJECT”

Gjatë vitit 2017 BMP ka realizuar disa aktivitete fillestare të nevojshme për realizimin e objektivave specifike të vitit të parë dhe në vijim. I përfshirë në projektin e Bankës Botërore “Support POB in performing the responsibilities of the Technical Secretariat” BMP është asistuar nga dy konsulentë, z. Aldo Spahiu dhe zj. Lirola Këri.

Nga ana e konsulentëve dhe në bashkëpunim me koordinatorët e Bankës Botërore, janë hartuar statuti dhe disa rregullore të nevojshme për vijim e punës së BMP. Në përmbajtjen e tyre këto rregullore vazhdojnë të transpozojnë nene nga Direktiva 2006/43 dhe rregullorja 537/2014 duke

vijuar më tej me përafrimin e legjislacionit në fushën e auditimit. Këto draft rregullore janë diskutuar në mbledhjet e Bordit dhe një pjesë e tyre janë miratuar. Gjithashtu konsulentët kanë dhënë asistencë edhe në draftimin VKM-së Nr. 51, datë 31.1.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM, Nr. 786, datë 9.11.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Rastet e Shkarkimit të Anëtarëve si dhe Rregullat e Organizimit e të Funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”

Korrik 2017 Miratimi i Statutit të BMP-së si dhe miratimi i Rregullores për Mbledhjen e të ardhurave

Statuti i BMP

Statuti i BMP është miratuar në mbledhjen e muajit korrik 2017 nga anëtarët e Bordit. Në këtë dokument themeltar janë përcaktuar parimet bazë të organizimit dhe administrimit të aktiviteteve të këtij institucioni. Statuti është i organizuar në pesë krerë ku janë paraqitur dispozitat e përgjithshme; misioni, organizimi, drejtimi dhe administrimi i bordit; veprimtaria ekzekutive; menaxhimi financiar; dhe dispozitat përfundimtare. Që në hyrje ritheksohet edhe një herë fakti i vendosur në ligjin e auditimit ku BMP është një autoritet rregullator i pavarur. Në statut janë mirë përcaktuar edhe organet përkatëse për realizimin e misionit të Bordit dhe arritjen e objektivave si organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës.

Rregullorja e të ardhurave të BMP

Në mbledhjen e muajit korrik 2017 është miratuar “Rregullorja për Mbledhjen e të Ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”. Kjo është një rregullore shumë e rëndësishme ku parashikohen në mënyrë të detajuar burimet e financimit të BMP, sipas mënyrave të parashikuara në ligji, dhe mënyrat e administrimit të këtyre burimeve. Me anë të këtyre burimeve sigurohet pavarësia e Bordit për të ushtruar funksionet mbikëqyrëse në sigurimi e cilësisë në shërbim të interesit publik. BMP mbikëqyr drejtpërsëdrejti audituesit ligjorë të njësive ekonomike me interes publik, si edhe indirekt me anë të mbikëqyrës të organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Së bashku me to BMP mbikëqyr edhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar. Në rregullore janë caktuar sigurimi i fondeve në masën 3% të shumave të faturuara për shërbimin e auditimit për njësitë ekonomike me interes publik dhe shuma 7% e vlerave të arkëtuara nga anëtarësia e organizatave profesionale. Përveç detyrimit për derdhjen e fondit organizatat profesionale duhet të depozitojnë brenda datës 31 mars të vitit pasardhës pasqyrat financiare, listën e anëtarëve aktivë dhe joaktivë si edhe burimet e arkëtimeve. Në rregullore janë

parashikuar edhe masat disiplinore në rastin e mos arkëtimeve në kohë. Në një nen të veçantë janë parashikuar sigurimi i fondeve të nevojshme nga buxheti i shtetit në rastet e aktiviteteve të rëndësishë së lartë kur nuk mund të mbulohen nga fondet e vetë Bordit.

Tetor 2017: Draftimi i Rregullores së funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale si dhe Rregullores së Investigimit dhe Disiplinës

Rregullorja e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale

Risi e ligjit 47/2016 është krijimi i komisionit për testimin dhe certifikimin e audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar. Përpara se të ngrihet komisioni duhet të hartohet dhe miratohet rregullorja përkatëse. Deri në fund të vitit 2017 është hartuar draft i parë i cili më pas do të kalohet për diskutim mes anëtarëve të Bordit dhe më pas tek palët e interesit për të marrë edhe mendimet e tyre përpara miratimit të versionit përfundimtar.

Rregullorja e investigimit dhe disiplinës

Një draft tjetër i rëndësishëm është edhe rregullorja për investigimin dhe disiplinën. Në kuadër të kontrollit të cilësisë procesi i investigimit është i rëndësishëm për të hetuar procesin e ofrimit të shërbimit të auditimit dhe sigurimin e cilësisë për interesin publik. Ndërkohë që vendosja e masave disiplinore është parashikuar në këtë rregullore në vijimësi të procesit të kontrollit të cilësisë. Këtu janë parashikuar edhe masat e tjera në rast të moszbatimit të rregulloreve të tjera.

Nëntor 2017 Regjistrimi në organet tatimore dhe marrja e NIPT-it të BMP-së

Regjistrimi

Në tremujorin e fundit të vitit 2017 BMP është regjistruar pranë zyrës së shërbimit të tatimpaguesve në Tiranë dhe është pajisur me NIPT L72212451Q i nevojshëm për zhvillimin normal të aktivitetit. Aktualisht hapja e NIPT është shoqëruar edhe me detyrimet përkatëse ligjore të cilat plotësohen online tek faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Vula

Në të njëjtën periudhë BMP është pajisur edhe me vulën zyrtare të institucionit të prodhuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Sektori i Prodhimit të Vulave.

Dhjetor 2018 Diskutimi për miratim i strategjisë së BMP-së të përgatitur nga Konsulenti Ndërkombëtar

Sipas përgjegjësiave të Bordit, çdo vit duhet të përgatitet një plan vjetor i punës, i cili siguron të gjitha objektivat specifike për atë vit, aktivitetet që duhen ndërmarrë për të arritur këto objektiva, organet përgjegjëse për këto objektiva dhe afati i fundit për kryerjen e aktiviteteve.

6. Në proces diskutimi

6.1. Manuali i investigimit

Manuali i investigimit do të jetë pjesë e pandarë e rregullores për investigimin dhe marrjen e masave disiplinore dhe është një ndër manualët më të rëndësishme në funksionit të kontrollit dhe investigimit të mëtejshëm të punës së audituesve ligjorë. Ende ky manual ka qenë në fazën e draftimit deri në fund të vitit 2017.

6.2. Rregullorja dhe Manuali i Kontrollit të cilësisë

6.2.1. Rregullorja

Aktualisht është në proces përgatitja e rregullores për kontrollin e cilësisë të Bordit të Mbikëqyrjes Publike për Audituesit Ligjor. Kjo rregullore po përgatitet në përputhje me asistencën e konsulentit ndërkombëtar.

6.2.2. Manuali i Kontrollit të cilësisë

Pa diskutim manuali i kontrollit të cilësisë është më i rëndësishmi për vetë misionin dhe natyrën e punës së BMP. Ky manual është në draftim e sipër. Është manual voluminoz i cili parashikon një detajim të të gjithë të dhënave dhe publikimeve që duhet të përmbajë dosja e audituesve ligjorë gjatë punës së tyre, në misionet e realizuara. E veçanta e këtij manuali është se do të transpozojë një pjesë të mirë të rregullores 537 të BE, duke vijuar më tej me këtë proces. Kjo jo vetëm që do të ndikojë në vijimin e mëtejshme të transpozimit, por do të mundësojnë përvetësimin e praktikave më të mira europiane për shërbimin e auditimit dhe cilësinë e shërbimit në interes të publikut.

6.3. Rregullorja e brendshme e Strukturës Mbështetëse të BMP

Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me ligjin për auditimin dhe parashikon organigramen e strukturës mbështetëse dhe mënyrën e funksionimit të strukturës mbështetëse. Kjo rregullore është ende në fazën e draftimit dhe parashikon ecurinë e punës së përditshme në mbështetje të aktiviteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

7. Bashkëpunimi ndërmjet BMP dhe organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit.

7.1. Bashkëpunimi me organizatat kombëtare

Për përmbushjen e funksionit të mbikëqyrjes, BMP ka mundësuar një komunikim të vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me institucione të ndryshme, organizata profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, autoritetet dhe rregullatorët. Informacion dhe ndihmë nga të gjitha palët me të cilat Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi, për çdo rast që përbën shkelje të ligjit, i ndryshuar për pastrimin e parave, apo të dyshuar për evazion fiskal, kontrabandë, korrupsionit, krimin ekonomik, të dyshuar për konflikt interesi, etj dhe se njëra palë është përfaqësuar nga një kompani profesionale e shërbimeve, qoftë auditues ose kontabilist i certifikuar, është shumë e vlefshme për përmbushjen cilësore të misionëve të Bordit. Kërkesat ligjore, por gjithashtu, interesi kombëtar kërkon që Bordi i Mbikëqyrjes Publike të jetë i vetëdijshëm, për të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin.

Është shumë e rëndësishme që BMP të hyjë në një marrëveshje bashkëpunimi me rregullatorët dhe autoritetet, të cilat veprojnë në fusha të ngjashme të ekonomisë dhe kanë funksione të përbashkëta si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Autoriteti i Konkurrencës, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Këto marrëveshje synojnë ofrimin e ndihmës të ndërsjellë në lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit në mes të institucionet mbi shkallën e zbatimit të Standardeve

Ndërkombëtare të Auditimit nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, kontabilistët e certifikuar, niveli i kontrollit të cilësisë së punës e tyre, si dhe Kodin e Etikës.

7.2. BMP – Anëtar i IFIAR

Që nga 12 shtatori 2011, Bordi Publik i Mbikëqyrjes është bërë anëtar i IFIAR -

Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit. Ky forum është një shoqatë e rregullatorëve të pavarur të auditimit nga 51 juridiksione, të dedikuara për përmirësimin e cilësisë së auditimit dhe nxitjen e bashkëpunimit rregullator në fushën e mbikëqyrjes së audituesve për t'i shërbyer interesit publik dhe për të rritur mbrojtjen e investitorëve.

Objektivat kryesore të IFIAR janë:

- Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës në fushën e auditimit me qëllimin kryesor të kontrollin e cilësisë së audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.
- Të nxisë bashkëpunimin në veprimtarinë rregullatorë ndërmjet anëtarëve të IFIAR.
- Mundësimi i një platforme të dialogut me organizata të tjera ndërkombëtare që kanë një interes në cilësinë e auditimit.

Përmes bashkëpunimit me IFIAR, BMP mund të marrë shumë informacione të tilla si:

- Informacion rreth aktiviteteve të IFIAR. Kjo zakonisht është informacion përshkruese dhe procedural i cili mbulon kryesisht çështjet organizative dhe procedurale të pranuar nga Anëtarët, duke përfshirë, për shembull, informacione të përgjithshme rreth organizatës dhe funksionet e saj, Kartën e saj, anëtarësimin e saj, procedurat e saj operative dhe oraret dhe programet e takimeve të ardhshme.
- Informacion rreth rezultateve të IFIAR dhe produkteve të punës. Ky zakonisht është informacion thelbësor dhe është miratuar nga anëtarësia, duke përfshirë, për shembull, vendimet e anëtarëve (parimet bazë, planet e punës), raportet vjetore, anketat (gjetjet e inspektimit), dokumentet informative dhe sfondin mbi lëndët e përzgjedhura, dokumentet e diskutimit dhe njoftimet për shtyp lidhur me mbledhjet plenare.

- Pikëpamjet dhe qëndrimet e IFIAR për temat specifike të lidhura me politikat në të dy standardet dhe çështje jo standarde, qoftë të kërkuara nga një organizatë tjetër ose të iniciuar nga Zyrtarët, Grupet e Punës ose anëtarët individualë. Kjo është shumë e rëndësishme për IFIAR-in të rritet shikueshmëria e tij publike, por gjithashtu është e rëndësishme për ne, si anëtare për të shprehur dhe shkëmbyer komentet dhe sugjerimet tona në lidhje me temat e lartpërmendura.
- Komunikime të tjera të tilla si informacioni rreth monitorimit të Grupit apo të zhvillimeve të ardhme. Ky komunikim do të lejojë që anëtarësimi të përditësohet në natyrën dhe përmbajtjen e kontakteve të tyre të jashtme në çështjet e IFIAR, duke përfshirë njoftimin e anëtarëve për pjesëmarrjen e tyre në takimet me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe paraqitjen e tyre publike në emër të IFIAR.

BMP duhet të mbajë një komunikim të vazhdueshëm me IFIAR përmes mënyrave të ndryshme me qëllim që të shkëmbejë përvojën dhe pjesëmarrjen e saj në aktivitete, të organizuara nga IFIAR, të përditësojnë me tendencat e fundit rregullatorë dhe mbikëqyrëse, si dhe aplikimi i parimeve dhe praktikave më të mira. Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm për intensifikimin kontaktet me homologët ka qenë dhe mbetet nevoja e harmonizimit të rregullatorit për legjislacionin e raportimit financiar me Direktivat e BE-së në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.